

V E N D I M
Nr.462, datë 22.7.1998

**PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHETËROR TË PUNËS ME POLICINË
E RENDIT**

Në mbështetje të nenit 6 të ligjit nr.7986, datë 13.5.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës ushtron kontroll mbi të gjithë personat juridikë e fizikë, qofshin ata punëdhënës, punëmarrës, persona të vetëpunësuar, anëtarë të familjeve të tyre, që punojnë në Republikën e Shqipërisë, në institucione, ndërmarrje shtetërore ose private, pavarësisht nga shtetësia dhe kombësia.

2. Inspektorëve të Inspektoratit Shtetëror të Punës duhet t'u krijohen të gjitha lehtësitë e nevojshme për kontrollin e subjekteve të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi pas identifikimit të tyre nëpërmjet dokumentit identifikues (fletënjohjes).

3. Inspektorët e Inspektoratit Shtetëror të Punës kanë të drejtë të kërkojnë ndihmë nga policia e rendit në rastet:

a) kur inspektorët pengohen në ushtrimin e kontrollit në subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi;

b) kur nuk sigurohet zbatimi i urdhrit të inspektorit të punës.

Në prefekturat të cilat kanë drejtori policie, njoftohet komisariati nën juridiksionin e të cilit ndodhet subjekti që kontrollohet.

4. Organet e rendit, me të marrë njoftimin nga Inspektorati Shtetëror i Punës, vijnë menjëherë në ndihmë të tij.

5. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Inspektorati Shtetëror i Punës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano